


ISO 9000



Standardet e serisë ISO 9000 janë standardet me të njohura ndër gjithë standardet e tjera të ISO-s. Standardet e serisë **ISO 9000 janë zbatuar nga një numër shumë i madh organizatash e kompanish në mbarë botën.** ISO 9000 është bërë reference mbarëkombëtare përse i përket kërkesave të menaxhimit të cilësisë.

Familja e **ISO 9000** jep rregullat për "**menaxhimin e cilësisë**". Kjo do të thotë që kompanitë që aspirojnë cilësi në produktet dhe shërbimet e tyre duhet të plotësojnë:

- **kërkesat që kanë konsumatorët për cilësinë;**
- **kërkesat në zbatim të legjislacionit,** duke synuar
- **rritjen e kënaqësisë së konsumatorit,** dhe
- **përmirësimin e vazhdueshëm të të gjithë performancës së kompanisë.**

Pjesa më e madhe e standardeve të ISO-s janë tepër të specifikuar për një produkt të veçantë, material ose proces. Megjithatë, standardet si ISO 9000, ISO 14000 etj. që kanë fituar një reputacion shumë të madh në nivel ndërkombëtar, njihen edhe si "standardet universale të menaxhimit të sistemit".

- **"Universale"** në këtë rast do të thotë që i njëjti standard mund të aplikohet në:
 - çdo organizatë/kompani e madhe apo e vogël qoftë, pavarësisht nga llojshmëria e produktit që nxjerr;
 - pavarësisht nëse "produkti" është shërbim;
 - në të gjithë apo në çdo sektor të aktivitetit, dhe
 - pavarësisht nëse është një ndërmarrje/kompani private, organizatë jo-qeveritare apo një departament shtetëror.

"Universal" gjithashtu do të thotë që pavarësisht nga fusha/qëllimi i aktivitetit dhe madhësia e organizatës/kompanisë, nëse ekziston dëshira për të ngritur dhe zbatuar një sistem për menaxhimin e cilësisë, përfitimet nga një sistem i tillë shprehen nga një numër karakteristikash esenciale për secilin nga standardet e familjes ISO 9000 që sigurojnë këto kërkesa.

- **"Sistemi i menaxhimit"** fokusohet në strukturën e organizatës për menaxhimin e proceseve – ose aktiviteteve të saj – që transformojnë **inputet në një produkt** apo **shërbim**, i cili përmbush objektivat e

organizatës, të tilla si plotësimi i kërkesave të klientëve për cilësinë, zbatimimi i legjislacionit në fuqi apo plotësimi i objektivave lidhur me mjedisin.

Standardet e familjes *ISO 9000* i gjeni në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (DPS) të përkthyer në shqip.

Standardet kryesore:

S SH ISO 9000 - Standarde për menaxhimin dhe sigurimin e cilësisë.

S SH ISO 9001 - Sistemet e menaxhimit të cilësisë - Kërkesat

S SH ISO 9004 - Sistemet e menaxhimit të cilësisë - Udhëzues për përmirësimet e performances.

Çmimet për standardet kryesore të familjes ISO 9000 janë:

Për Bashkëpunëtor

S SH ISO 9000 – 32 faqe – 1993 lekë

S SH ISO 9001 – 33 faqe – 2082 lekë

S SH ISO 9004 – 74 faqe – 3064 lekë

Për Jobashkëpunëtor

S SH ISO 9000 – 32 faqe – 3986 lekë

S SH ISO 9001 – 33 faqe – 4165 lekë

S SH ISO 9004 – 74 faqe – 6128 lekë

Na kontaktoni:

Rruga "Mine Peza", Nr.143/3,
1014 - Tiranë, Shqipëri
Kutia Postare 98
Tel: (04) 22 62 55; (04) 24 71 75
Fax: (04) 24 71 77
E-mail: info@dps.gov.al

Përgatiti
Kostanca Dedja
DPS